

VENDIM
Nr.539, datë 21.12.1992

PËR NJËSITË E MATJES

Në mbështetje të ligjit nr.7625, datë 20.10.1992 "Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)", Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranimin e njësive ligjore të matjes si më poshtë:

Njësitë bazë:

a) për gjatësinë: metri (m), i cili është i barabartë me gjatësinë e largësisë së përshkuar nga drita në boshllëk gjatë një kohe prej $1/299792458$ të sekondës.

b) Për masën: kilogrami (kg), i cili është i barabartë me masën e prototipit ndërkombëtar të kilogramit.

c) Për kohën: sekonda (s), e cila është e barabartë me kohezgjatjen e $9\,192\,631\,770$ periodave të rrezatimit që I përgjigjet kalimit ndërmjet dy niveleve supe: fundore të gjetjes themelore të atomit të ceziumit 133.

ç) Për intensitetin e rrymës elektrike: amperi (A), i cili është intensiteti i një rryme të pandryshueshme që, duke kaluar nëpër dy përcjellës drejtvizorë e paralelë, me gjatësi të pafundme, me prerje të papërfillshme dhe të vendosur në një largësi 1 m në zbrazëtirë, bën që të bashkëveprojnë ndërmjet tyre me një forcë prej 2.10^{-7} njuton për çdo meter gjatësi.

d) Për temperaturën termodinamike: kelvin (K), i cili është i barabartë me $1/273.16$ pjesë të tremperaturës termodinamike të pikës trefishe të ujit.

dh) Për sasinë e lëndës: mol (mol), i cili është i barabartë me sasinë e lëndës të një sistemi që përmban aq njësi elementare sa ka atome në 0.012 kg të karbonit 12.

e) Për intensitetin e dritës: kandela (cd), e cila është e barabartë me intensitetin e dritës të një burimi që lëshon në një drejtim të dhënë një rrezatim një ngjyrëshme frekuencë 540×10^{12} herë dhe me intensitet energjetik $1/683$ vat për steradian në këtë drejtim.

Njësitë plotësuese:

a) Për këndin plan: radiani (rad), që është i barabartë me këndin plan, i cili, duke pasurt kulmin në qendrën e një rrethi, pret në perimetrin e tij një hark me gjatësi sa rrezja e rrethit.

b) Për këndin e ngurtë: steradiani (sr), që është i barabartë me këndin e ngurtë, i cili, duke pasur kulmin në qendrën e një sfere, pret në sipërfaqen e kësaj sfere një syprinë të barabartë me atë të një katrori që ka gjatësinë e brinjëve sa rrezja e sferës.

2. Njësitë me emërtim të veçantë që rrjedhin nga njësitë bazë dhe njësitë plotësuese jepen në tabelën 1.

3. Njësitë që lejohen të përdoren krahas atyre të dhëna në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, jepen në tabelën 2.

Njësitë jashtë sistemit SI që lejohen të përdoren, jepen në tabelë 3.

Parashtesat për formimin e nënfishave dhe shumëfishave të njësive të matjes jepen në tabelë 4.

4. Rregullat për drejtpërdorimin e njësive të matjes janë:

a) Njësitë e rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar SI formohen nga njësitë bazë ose plotësuese nëpërmjet shprehjeve algjebrike që lidhin madhësitë koresponduese.

b) Çdo madhësi në sistemin ndërkombëtar SI ka një njësi të vetme, kurse e anasjellta nuk është e vërtetë.

c) Vlerat e madhësive të quajtura pa përmasa shprehen vetëm me numra dhe paraqesin raportin e dy madhësive të së njëjtës natyrë.

ç) Simbolet e njësive shkruhen me shkronja latine dhe në përgjithësi të vogla. Në rastet kur emri i njësisë rrjedh nga një emër i përveçëm, shkronja e parë e simbolit bëhet e madhe, p.sh. Pa (paskali), A (amper), etj.

d) Emri i plotë i një njësie shkruhet me shkronjë të vogël.

dh) Simbolet e njësive mbeten të pandryshuara, kur vlera e madhësisë ndryshon nga njësia.

e) Simbolet e njësive nuk ndiqen nga pika mbrapa, me përjashtim të rasteve kur ndodhen në

fund të fjalisë.

ë) Nëse një njësi shoqërohet me madhësi relative, duhet që ajo të tregohet vetëm me simbolin e vendosur prapa vlerës numerike.

f) Produkti i dy ose më shumë njësive shënohet me një nga mënyrat e mëposhtme:

N.m; N.m: Nm

g) Kur një njësi e rrjedhur formohet nga pjestimi i dy njësive, përdoret një vijë e pjerrët (/), një vijë horizontale ose eksponente negative, p.sh.:

J/s; J-s ; J.s-1

gj) Në një rresht asnjëherë nuk përdoret më shumë se një vijë e pjerrët, me përjashtim të rastit kur janë vendosur kllapat, p.sh.:

m.kg/(s³/A) ose m.kg-3.s.A, por jo m.kg/s/A

h) Shumëfishat dhe nënfishat e njësisë së masës formohen nga bashkimi i parashtesave me fjalën "Gram", simboli i të cilit është g, p.sh. 10-6kg = 1 mg dhe jo 10-6kg = 1ukg.

i) Simbolet e parashtesave shkruhen me shkronja latine pa largësi ndërmjet simbolit të parashtesës dhe simbolit të njësisë.

j) Nuk lejohet të përdoren parashtesa të përbëra.d.m.th. të formuara nga vendosja e shumë parashtesave, p.sh pF dhe yyF ose ns dhe jo mus.

k) Një parashtesë nuk lejohet të përdoret vetëm.

l) Nëse simbolit të njësisë të ngritur në një fuqi i vihet një parashtesë, atëherë edhe parashtesa kuptohet që është e ngritur në atë fuqi, p.sh.:

$$1 \text{ cm}^3 = (10^{-2})^3 = 10^{-6} \text{ m}^3$$

$$1 \text{ ns}^{-1} = (10^{-9}\text{s})^{-1} = 10^9 \text{ s}^{-1}$$

ll) Nuk lejohet zbatimi i parashtesave SI në:

- ndarjen e rreshtit në 360;
- minutën, orën dhe ditën;
- arin dhe hektarin
- karatin metrik;
- dioptrin;
- decibelin.

5. Dispozitat dhe aktet e tjera nënligjore që bien nëkundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi